



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHITIME
Nr.01-060/01-24952/25 datë:19.09.2025



Npi – 01/315 datë: 26.09.2025

Bazuar në nenin 12.2. pika (c), nenin 40.2 pika (g), dhe nenin 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Neneve 10 deri në 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna; Nenin 14 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe duke u bazuar në nenin 11.1 të Rregullores Komunale për Transparencë Npi – 01/205 datë: 14.07.2017; Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më: 26.09.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR TA NXJERRË NË DISKUTIM PUBLIK
DRAFT-RREGULLOREN KOMUNALE PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR
VITIN 2026

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 26.09.2025, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2026. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria Komunale për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

II

Kuvendi i Komunës ka marrë për bazë edhe rekomandimin nga Komiteti për Politikë dhe Financa, Npi-01/310 dt.24.09.2025, dhe Rekomandimin nga Komiteti për Komunitete Npi-01/311 dt.25.09.2025.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi